



Funded by
the European Union



RAPORT MONITORIMI KOMUNITAR

Aksesi në shërbimet e qendrave shëndetësore / ambulancave parësore për rastet e dhunës me bazë gjinore në Njësinë Administrative Ndroq, Bashkia Tiranë

Raporti mbi monitorimin komunitar u zhvillua nga Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS në kuadër të projektit “Tirana për Gratë: Barazi, Mbrojtje dhe Fuqizim”, i financuar nga Bashkimi Europian dhe i zbatuar nga Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim (GADC), në partneritet me Shoqatën Together for Life (TFL) dhe Institute of Romani Culture in Albania (IRCA).

Mars, 2026

**Ky raport është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti pasqyron vetëm pikëpamjet e autorit. Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për asnjë përdorim që mund t'i bëhet informacionit që përmban ky dokument.*



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Hyrje

Ky raport paraqet rezultatet e një monitorimi komunitar të realizuar për të vlerësuar aksesin dhe përvojën e grave dhe vajzave me shërbimet shëndetësore, me fokus të veçantë në trajtimin e rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore (GBV) në Njësinë Administrative Ndroq në Bashkinë Tiranë. Monitorimi u zhvillua përmes pyetësorëve dhe vëzhgimeve të një grupi komunitar, të përbërë nga 10 antarë vullnetarë të komunitetit, të angazhuar në mënyrë aktive për të evidentuar pengesat dhe sfidat praktike që përballen përdoruese të shërbimeve.

Ky proces kishte për qëllim të identifikojë barrierat fizike, financiare dhe informuese, si dhe sfidat lidhur me oraret, privatësinë dhe sigurinë gjatë përdorimit të qendrave shëndetësore. Raporti paraqet gjetjet kryesore, përvojat dhe perceptimet e pjesëmarrëseve, duke përfshirë njohuritë mbi mekanizmat e referimit për shërbime sociale, psikologjike dhe ligjore.

Në bazë të këtyre gjetjeve, raporti ofron rekomandime praktike për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, duke synuar krijimin e një mjedisi më të ndjeshëm, të drejtë dhe të aksesueshëm për të gjitha gratë dhe vajzat, veçanërisht për ato që përjetojnë dhunë me bazë gjinore. Dokumenti synon të shërbejë si udhërrëfyes për institucionet lokale dhe aktorët e shoqërisë civile, për zhvillimin e politikave dhe praktikave që fuqizojnë komunitetin dhe mbështesin pjesëmarrjen aktive të grave dhe vajzave në përdorimin e shërbimeve shëndetësore.

Qëllimi i raportit:

Ky raport ka për qëllim të vlerësojë aksesueshmërinë, cilësinë dhe efektivitetin e shërbimeve shëndetësore për gratë dhe vajzat në Njësinë Administrative Ndroq, me fokus të veçantë në trajtimin e rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore (GBV). Ai synon të identifikojë pengesat dhe nevojat kryesore, të evidentojë përvojat dhe perceptimet e përdorueseve të shërbimeve, dhe të ofrojë rekomandime konkrete për përmirësimin e qendrave shëndetësore, duke i bërë ato më të ndjeshme, të arritshme dhe të drejtë për të gjithë.

Objektivat e raportit

Raporti synon të:

- Evidentojë niveli i aksesit dhe përdorimit të shërbimeve shëndetësore nga gratë dhe vajzat në komunitet.
- Identifikojë pengesat dhe barrierat që ndalojnë ose vështirësojnë përdorimin e shërbimeve, përfshirë faktorët financiarë, oraret, transportin dhe mungesën e informacionit.
- Analizojë përvojat direkte të përdoruesve me shërbimet shëndetësore dhe mekanizmat e referimit për raste GBV.
- Mbledhë dhe përpunojë të dhëna që të mundësojnë rekomandime për përmirësim të qendrave shëndetësore dhe shërbimeve për gratë dhe vajzat, duke përfshirë aksesin, cilësinë dhe ndjeshmërinë ndaj nevojave të tyre.
- Promovojë pjesëmarrjen komunitare dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e shërbimeve shëndetësore dhe mbështetjes për viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Metodologjia

Ky raport paraqet analizën e të dhënave të mbledhura përmes një procesi vlerësimi mbi aksesueshmërinë dhe efektivitetin e shërbimeve shëndetësore për gratë dhe vajzat, me fokus të veçantë trajtimin e rasteve të Dhunës me Bazë Gjinore (GBV) pranë Njësisë Administrative Ndroq, bashkia Tiranë. Ky raport u përgatit bazuar në procesin e monitorimit komunitar të zhvilluar gjatë periudhës dhjetor 2025 – shkurt 2026.

Raporti bazohet në gjetjet e nxjerra nga një pyetësor i strukturuar, i cili synon të evidentojë pengesat sistematike dhe nevojat për ndërhyrje në infrastrukturën shëndetësore lokale. Të dhënat janë mbledhur përmes një pyetësori anonim dhe konfidencial, i cili garanton mbrojtjen e identitetit të pjesëmarrësve sipas standardeve etike të kërkimit. Instrumenti i përdorur përfshin 16 pyetje të strukturuar që mbulojnë të dhënat demografike, disponueshmërinë e shërbimeve, barrierat e perceptuara dhe eksperiencën direkte me sistemin e referimit. Mostra e përzgjedhur përfaqëson grupmosha dhe statuse civile të ndryshme, duke ofruar një pasqyrë të gjerë të perceptimit publik mbi sistemin shëndetësor.

Pyetësorët janë plotësuar fizikisht nga një kampion i përbërë prej 30 vajzash dhe grash të përzgjedhura në mënyrë të rastësishme nga komuniteti i Njësisë Administrative Ndroq dhe përpunimi i gjetjeve është kryer nëpërmjet programit Microsoft Excel. Përzgjedhja në mënyrë të rastësishme është bërë me qëllim që të sigurohet një përfaqësim sa më i gjerë i mendimeve

dhe përvojave të grave dhe vajzave në këtë komunitet, duke mundur kështu një pasqyrë më reale të situatës dhe nevojave të tyre.

Në procesin e shpërndarjes dhe plotësimit të pyetësorëve është angazhuar vullnetarisht një grup prej 10 studentesh nga Shkolla e Mesme “Sadi Nuri” në Ndroq. Studentet kanë kontribuar në mënyrë aktive në kontaktimin e pjesëmarrëseve, shpjegimin e qëllimit të pyetësorit dhe asistimin gjatë plotësimit të tij. Angazhimi i tyre ka qenë thelbësor për realizimin e procesit të mbledhjes së të dhënave në terren, duke ndihmuar që pyetësorët të plotësohen në mënyrë të rregullt dhe brenda afatit të përcaktuar.

Ky bashkëpunim vullnetar jo vetëm që ka lehtësuar procesin e mbledhjes së informacionit, por gjithashtu ka krijuar një mundësi për përfshirjen e të rinjve në aktivitete me karakter social dhe komunitar, duke i ndërgjegjësuar ata mbi rëndësinë e pjesëmarrjes në iniciativa që synojnë përmirësimin e mirëqenies së komunitetit.


Të dhënat demografike

Të dhënat mbi moshën e pjesëmarrëseve tregojnë shpërndarjen e grupmoshave të përfshira në pyetësor. Nga gjithsej **30 të anketuara, 10 pjesëmarrëse i përkasin grupmoshës 18–25 vjeç**, duke përbërë numrin më të madh të përgjigjeve në këtë kategori. Ndërkohë, **6 pjesëmarrëse i përkasin grupmoshës 26–35 vjeç, 6 të tjera grupmoshës 36–45 vjeç, si dhe 6 pjesëmarrëse janë mbi 45 vjeç**. Në të njëjtën kohë, **2 nga të anketuarat janë nën 18 vjeç**. Këto të dhëna paraqesin përbërjen e mostrës sipas kategorive të ndryshme të moshës së pjesëmarrëseve në pyetësor.

Mosha					
18–25 vjeç	26–35 vjeç	36–45 vjeç	Mbi 45 vjeç	Nën 18 vjeç	Grand Total
10	6	6	6	2	30

Statusi Civil:

Të dhënat mbi statusin civil tregojnë se nga **30 pjesëmarrëse në pyetësor, 19 janë të martuara ose në bashkëjetesë, 9 janë beqare, ndërsa 2 janë të veja**. Kjo shpërndarje paraqet përbërjen e mostrës sipas statusit civil të të anketuarave





Pyetja 1: A ka një qendër shëndetësore / ambulancë në zonën tuaj që funksionon rregullisht?

Të dhënat tregojnë se nga 30 pjesëmarrëse, 27 kanë deklaruar se në zonën e tyre ka një qendër shëndetësore ose ambulancë që funksionon rregullisht, ndërsa 3 kanë deklaruar se nuk e dinë.

<i>A ka një qendër shëndetësore / ambulancë në zonën tuaj që funksionon rregullisht?</i>		
Nuk e di	Po	Grand Total
3	27	30

Pyetja 2: Sa kohë ju duhet të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën më të afërt nga shtëpia juaj?

Sa i përket kohës së nevojshme për të arritur në qendrën shëndetësore ose ambulancën më të afërt, 16 pjesëmarrëse kanë deklaruar se u duhen më pak se 15 minuta, 13 pjesëmarrëse 15–30 minuta, ndërsa 1 pjesëmarrëse 31–60 minuta.

<i>Sa kohë ju duhet të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën më të afërt nga shtëpia juaj?</i>			
15–30 minuta	31–60 minuta	Më pak se 15 minuta	Grand Total
13	1	16	30

Pyetja 3: Sa e lehtë është për ju të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën kur keni nevojë për ndihmë?

Në lidhje me lehtësinë për të shkuar në qendrën shëndetësore ose ambulancën kur kanë nevojë për ndihmë, 17 pjesëmarrëse e kanë vlerësuar si të lehtë, 9 si shumë të lehtë, 3 pjesëmarrëse e kanë konsideruar të vështirë, ndërsa 1 pjesëmarrëse shumë të vështirë.

<i>Sa e lehtë është për ju të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën kur keni nevojë për ndihmë?</i>				
E lehtë	E vështirë	Shumë e lehtë	Shumë e vështirë	Grand Total
17	3	9	1	30

Pyetja 4: Çfarë pengesash keni për të shkuar në qendrën shëndetësore / ambulancën? (mund të zgjidhni më shumë se një)

Lidhur me pengesat për të shkuar në qendrën shëndetësore ose ambulancën, 12 pjesëmarrëse kanë deklaruar se nuk kanë pengesa, 5 kanë përmendur se orari nuk është i përshtatshëm, 4 kanë përmendur mungesën e transportit, 4 distancën e madhe, 3 frikën ose turpin, ndërsa 2 pjesëmarrëse kanë deklaruar se duhet të kujdesen për fëmijët.



<i>Çfarë pengesash keni për të shkuar në qendrën shëndetësore / ambulancën?</i>						
Distanca e madhe	Duhet të kujdesem për fëmijët	Frikë ose turp	Nuk ka transport	Nuk kam pengesa	Orari nuk është i përshtatshëm	Grand Total
4	2	3	4	12	5	30

Pyetja 5: A ofron qendra shëndetësore / ambulanca shërbime për gratë ose vajzat që kanë përjetuar dhunë?

Në lidhje me ofrimin e shërbimeve për gratë ose vajzat që kanë përjetuar dhunë, 7 pjesëmarrëse kanë deklaruar se qendra shëndetësore ofron shërbime të tilla, 9 kanë deklaruar se nuk ofrohen, ndërsa 14 pjesëmarrëse kanë deklaruar se nuk e dinë.

<i>A ofron qendra shëndetësore / ambulanca shërbime për gratë ose vajzat që kanë përjetuar dhunë?</i>			
Jo	Nuk e di	Po	Grand Total
9	14	7	30

Pyetja 6: Nëse do të përjetonit dhunë, sa e mundshme do të ishte që të kërkonit ndihmë në qendrën shëndetësore / ambulancën?

Sa i përket mundësisë për të kërkuar ndihmë në qendrën shëndetësore ose ambulancë në rast se do të përjetonit dhunë, 10 pjesëmarrëse janë përgjigjur se është e mundshme, 2 shumë e mundshme, 12 pak e mundshme, ndërsa 6 janë përgjigjur se është aspak e mundshme.

<i>Nëse do të përjetonit dhunë, sa e mundshme do të ishte që të kërkonit ndihmë në qendrën shëndetësore / ambulancën?</i>				
Aspak e mundshme	E mundshme	Pak e mundshme	Shumë e mundshme	Grand Total
6	10	12	2	30

Pyetja 7: Sa e informuar ndiheni për shërbimet që qendra shëndetësore / ambulanca ofron për dhunën?

Në lidhje me nivelin e informimit për shërbimet që ofrohen për rastet e dhunës, 19 pjesëmarrëse janë shprehur se ndihen pjesërisht të informuara, 7 aspak të informuara, ndërsa 4 janë shprehur se ndihen shumë të informuara.

<i>Sa e informuar ndiheni për shërbimet që qendra shëndetësore / ambulanca ofron për dhunën?</i>			
Aspak e informuar	Pjesërisht e informuar	Shumë e informuar	Grand Total
7	19	4	30



Pyetja 8: A ndiheni e sigurt që të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën pa pasur dikë nga familja me vete?

Sa i përket ndjenjës së sigurisë për të shkuar në qendrën shëndetësore ose ambulancën pa pasur dikë nga familja me vete, 18 pjesëmarrëse janë përgjigjur “po”, 8 “ndonjëherë”, ndërsa 4 janë përgjigjur “jo”.

<i>A ndiheni e sigurt që të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën pa pasur dikë nga familja me vete?</i>			
Jo	Ndonjëherë	Po	Grand Total
4	8	18	30

Pyetja 9: A mendoni se stafi i qendrës shëndetësore / ambulancës respekton privatësinë e grave dhe vajzave që kërkojnë ndihmë?

Lidhur me respektimin e privatësisë së grave dhe vajzave nga stafi i qendrës shëndetësore ose ambulancës, 16 pjesëmarrëse mendojnë se privatësia respektohet, 8 nuk e dinë, ndërsa 6 janë përgjigjur negativisht.

<i>A mendoni se stafi i qendrës shëndetësore / ambulancës respekton privatësinë e grave dhe vajzave që kërkojnë ndihmë?</i>			
Jo	Nuk e di	Po	Grand Total
6	8	16	30

Pyetja 10: A ndiheni e dëgjuar dhe e trajtuar me respekt nga stafi i qendrës shëndetësore / ambulancës?

Sa i përket ndjenjës për t’u dëgjuar dhe trajtuar me respekt nga stafi shëndetësor, 11 pjesëmarrëse janë përgjigjur se ndihen rrallë të dëgjura dhe të trajtuara me respekt, 10 shpesh, ndërsa 9 gjithmonë.

<i>A ndiheni e dëgjuar dhe e trajtuar me respekt nga stafi i qendrës shëndetësore / ambulancës?</i>			
Gjithmonë	Rrallë	Shpesh	Grand Total
9	11	10	30

Pyetja 11: A jep qendra shëndetësore / ambulanca informacion ose ju referon drejt shërbimeve të tjera (sociale, psikologjike, ligjore)?

Në lidhje me ofrimin e informacionit ose referimin drejt shërbimeve të tjera (sociale, psikologjike apo ligjore), 11 pjesëmarrëse janë përgjigjur “nuk e di”, 14 kanë deklaruar “po”, ndërsa 5 kanë deklaruar “jo”.

<i>A jep qendra shëndetësore / ambulanca informacion ose ju referon drejt shërbimeve të tjera (sociale, psikologjike, ligjore)?</i>			
Jo	Nuk e di	Po	Grand Total
5	11	14	30

Pyetja 12: Sa e lehtë është që të referoheni nga qendra shëndetësore / ambulanca për të marrë shërbime të tjera?

Sa i përket lehtësisë së referimit për shërbime të tjera nga qendra shëndetësore ose ambulanca, 21 pjesëmarrëse e kanë vlerësuar si të lehtë, 5 nuk kanë pasur përvojë, 2 e kanë konsideruar të vështirë, ndërsa nga 1 pjesëmarrëse e kanë vlerësuar si shumë të lehtë dhe 1 si shumë të vështirë.

<i>Sa e lehtë është që të referoheni nga qendra shëndetësore / ambulanca për të marrë shërbime të tjera?</i>					
E lehtë	E vështirë	Nuk kam pasur përvojë	Shumë e lehtë	Shumë e vështirë	Grand Total
21	2	5	1	1	30

Pyetja 13: Si do ta vlerësonit marrjen e shërbimeve në qendrën shëndetësore / ambulancën për rastet e dhunës me bazë gjinore?

Në vlerësimin e përgjithshëm të marrjes së shërbimeve për rastet e dhunës me bazë gjinore në qendrën shëndetësore ose ambulancë, 22 pjesëmarrëse e kanë vlerësuar shërbimin si të mirë, 5 si mesatar, 3 si shumë të mirë.

<i>Si do ta vlerësonit marrjen e shërbimeve në qendrën shëndetësore / ambulancën për rastet e dhunës me bazë gjinore?</i>			
E mirë	Mesatare	Shumë e mirë	Grand Total
22	5	3	30

Pyetja 14: Çfarë mendoni se do të përmirësonte më shumë aksesin në shërbime për gratë dhe vajzat në qendrën shëndetësore / ambulancën?

Pjesëmarrëset u përgjigjën përmes komenteve dhe sugjerimeve të dhëna në formë të hapur. Përgjigjet e tyre përfshinin ide dhe propozime konkrete mbi mënyrat se si mund të përmirësohet aksesin dhe cilësia e shërbimeve shëndetësore për gratë dhe vajzat në komunitet.

Sugjerimet e mbledhura janë analizuar dhe përmbledhur tematikisht, duke u reflektuar më pas në formën e rekomandimeve në pjesën përmbyllëse të raportit. Këto rekomandime lidhen kryesisht me përmirësimin e infrastrukturës së qendrave shëndetësore, rritjen e stafit dhe shërbimeve të specializuara, zgjerimin e orareve të shërbimit, ofrimin e më shumë shërbimeve falas, si dhe rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të grave dhe vajzave mbi shërbimet e disponueshme.

Gjithashtu, një pjesë e sugjerimeve thekson rëndësinë e mbështetjes psikologjike, respektimit të privatësisë dhe krijimit të një mjedisi të sigurt dhe të besueshëm për gratë dhe vajzat që kërkojnë shërbime shëndetësore.

Përfundime

Gjetjet e këtij vlerësimi tregojnë se në Njësinë Administrative Ndroq ekziston një disponueshmëri bazë e shërbimeve shëndetësore, pasi shumica e grave dhe vajzave të anketuara konfirmojnë se në zonën e tyre funksionon rregullisht një qendër shëndetësore. Në përgjithësi, koha e nevojshme për të arritur në qendër perceptohet si e arsyeshme. Megjithatë, përvojat individuale lidhur me aksesin nuk janë të njëjta. Ndërsa disa pjesëmarrëse e konsiderojnë të lehtë arritjen dhe përdorimin e shërbimeve, të tjera raportojnë vështirësi që lidhen kryesisht me mungesën e transportit, distancën dhe oraret e papërshtatshme të shërbimeve. Këto faktorë përbëjnë pengesa praktike që mund të ndikojnë në përdorimin e rregullt të shërbimeve shëndetësore nga gratë dhe vajzat.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me nivelin e informimit mbi shërbimet që lidhen me dhunën me bazë gjinore. Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrëseve nuk janë të sigurta nëse qendra shëndetësore ofron shërbime të dedikuara për këtë çështje dhe vetëm një numër i kufizuar deklarojnë se janë shumë mirë të informuara. Kjo mungesë informacioni ndikon edhe në gatishmërinë për të kërkuar ndihmë, pasi disa gra nuk e shohin shumë të mundshme kërkimin e asistencës në rast të përjetimit të dhunës. Po ashtu, njohuritë mbi mekanizmat e referimit drejt shërbimeve sociale, psikologjike dhe ligjore rezultojnë të kufizuara për një pjesë të pjesëmarrëseve, megjithëse ato që kanë pasur përvojë me këtë proces e vlerësojnë atë si relativisht të lehtë.

Perceptimet mbi sigurinë personale dhe ruajtjen e privatësisë përbëjnë gjithashtu një element të rëndësishëm në vlerësimin e shërbimeve. Disa prej grave dhe vajzave ndihen të sigurta për të vizituar qendrën shëndetësore pa shoqërim dhe shprehin besim ndaj stafit për respektimin e konfidencialitetit. Megjithatë, ky besim nuk është i njëjtë për të gjitha pjesëmarrëset. Përvoja e drejtpërdrejtë me stafin shëndetësor sugjeron se ekziston nevojë për përmirësim në komunikim dhe në trajtimin e ndjeshëm dhe respektues ndaj grave dhe vajzave, në mënyrë që shërbimet të perceptohen si më të sigurta dhe më mbështetëse.

Në përgjithësi, shërbimet ekzistuese perceptohen si funksionale dhe vlerësimi i tyre në lidhje me trajtimin e çështjeve të dhunës me bazë gjinore është kryesisht pozitiv. Megjithatë, rezultatet e këtij vlerësimi tregojnë se ekziston hapësirë për përmirësime, veçanërisht në drejtim të rritjes së informimit dhe ndërgjegjësimin në komunitet, forcimit të kapaciteteve profesionale të stafit, përmirësimit të aksesit praktik në shërbime dhe zhvillimit të mëtejshëm të mekanizmave mbështetës për gratë dhe vajzat në komunitetin e Ndroqit.

Rekomandime për përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për gratë dhe vajzat

Bazuar në gjetjet e pyetësorit dhe sugjerimet e dhëna nga pjesëmarrëset, janë identifikuar disa fusha prioritare ndërhyrjeje që do të kontribuonin në përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve shëndetësore për gratë dhe vajzat në komunitet.

1. Përmirësimi i aksesit financiar në shërbimet shëndetësore

Pjesëmarrëset theksuan nevojën për reduktimin e barrierave financiare që shpesh kufizojnë aksesin e grave dhe vajzave në shërbimet shëndetësore. Në këtë kuadër rekomandohet:

- Ulja e kostove të shërbimeve shëndetësore dhe zgjerimi i mundësive për sigurim shëndetësor falas, veçanërisht për gratë dhe familjet në situatë ekonomike të vështirë.
- Ofrimi i shërbimeve falas ose të subvencionuara për kategori vulnerabël.
- Sigurimi i medikamenteve bazë dhe trajtimeve të domosdoshme në qendrat shëndetësore dhe ambulanca.

2. Forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe zgjerimi i shërbimeve mjekësore

Një nga shqetësimet kryesore të evidentuara lidhet me mungesën e stafit dhe shërbimeve të specializuara. Për këtë arsye rekomandohet:

- Rritja e numrit të stafit mjekësor, duke përfshirë mjekë specialistë si gjinekologë dhe psikologë.
- Organizimi i shërbimeve në dy turne, për të mundësuar akses më të madh për komunitetin.
- Ofrimi i trajnimeve të vazhdueshme për stafin shëndetësor, me fokus në komunikimin me pacientët, ndjeshmërinë gjinore dhe trajtimin e rasteve vulnerabël.
- Zgjerimi i shërbimeve specifike për gratë dhe vajzat, përfshirë kontrollet gjinekologjike, analizat bazë dhe ndjekjen e shtatzënisë.

3. Përmirësimi i infrastrukturës dhe pajisjeve shëndetësore

Infrastruktura dhe pajisjet e pamjaftueshme ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë dhe aksesin në shërbime. Në këtë drejtim rekomandohet:

- Investimi në përmirësimin e infrastrukturës së qendrave shëndetësore dhe ambulancave.
- Pajisja e qendrave shëndetësore me aparatura dhe pajisje teknologjike të nevojshme për diagnostikim dhe trajtim.
- Zgjerimi i rrjetit të ambulancave dhe shërbimeve në zonat rurale, për të reduktuar distancën dhe vështirësitë në akses.

4. Rritja e informimit dhe ndërgjegjësimin në komunitet

Një pjesë e grave dhe vajzave nuk kanë informacion të mjaftueshëm mbi shërbimet ekzistuese dhe shërbimet parandaluese. Për këtë arsye rekomandohet:

- Organizimi i fushatave periodike informuese dhe ndërgjegjësuere mbi shërbimet shëndetësore të disponueshme.
- Shpërndarja e materialeve informuese dhe broshurave mbi shëndetin e grave dhe vajzave.

- Informimi mbi kontrollet parandaluese, përfshirë depistimin për kancerin e gjirit, kancerin e qafës së mitrës dhe sëmundjet seksualisht të transmetueshme.
- Promovimi i edukimit shëndetësor përmes aktiviteteve informuese mbi ushqyerjen, higjienën dhe kujdesin ndaj vetes.

5. Forcimi i shërbimeve për shëndetin seksual, riprodhues dhe mendor

Gratë dhe vajzat kanë theksuar rëndësinë e rritjes së shërbimeve të specializuara në këtë fushë. Në këtë kuadër rekomandohet:

- Ofrimi i këshillimit për shëndetin seksual dhe riprodhues, përfshirë informimin mbi ciklin menstrual, planifikimin familjar dhe mbrojtjen nga sëmundjet.
- Sigurimi i kontrolleve mjekësore të rregullta dhe shërbimeve gjinekologjike.
- Zgjerimi i shërbimeve të mbështetjes psikologjike, duke pasur parasysh nivelin e lartë të stresit, ankthit dhe problematikave sociale që përballen shumë gra.

6. Mbështetje për gratë dhe vajzat viktime të dhunës

Një tjetër nevojë e identifikuar lidhet me ofrimin e mbështetjes për gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë. Për këtë arsye rekomandohet:

- Krijimi ose forcimi i shërbimeve të specializuara për viktimat e dhunës, përfshirë këshillimin psikologjik dhe mekanizmat e referimit në shërbime të tjera mbështetëse.
- Garantimi i privatësisë, konfidencialitetit dhe trajtimit me respekt gjatë ofrimit të shërbimeve shëndetësore.
- Promovimi i qendrave shëndetësore si hapësira të sigurta ku gratë dhe vajzat mund të kërkojnë mbështetje.

7. Përmirësimi i aksesit fizik dhe bashkëpunimi institucional

Për të rritur përdorimin e shërbimeve shëndetësore nga komuniteti rekomandohet:

- Zgjatja e orareve të shërbimeve në qendrat shëndetësore.
- Shqyrtimi i mundësive për lehtësimin e transportit drejt qendrave shëndetësore, veçanërisht për zonat më të largëta.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitutional me institucione publike dhe organizata të shoqërisë civile për zgjerimin e shërbimeve dhe rritjen e informimit në komunitet.

ANEKS 1: PYETËSOR

Akresi në shërbimet e qendrave shëndetësore / ambulancave parësore për rastet e dhunës me bazë gjinore

Ky pyetësor është anonim dhe konfidencial. Përgjigjet tuaja do të përdoren vetëm për qëllime studimore dhe për të përmirësuar shërbimet shëndetësore për gratë dhe vajzat që përjetojnë dhunë me bazë gjinore.

1. Moshë:
 - Nën 18 vjeç
 - 18–25 vjeç
 - 26–35 vjeç
 - 36–45 vjeç
 - Mbi 45 vjeç
2. Statusi civil:
 - Beqare
 - E martuar / bashkëjetuese
 - E divorcuar
 - E ve
3. A ka një qendër shëndetësore / ambulancë në zonën tuaj që funksionon rregullisht?
 - Po
 - Jo
 - Nuk e di
4. Sa kohë ju duhet të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën më të afërt nga shtëpia juaj?
 - Më pak se 15 minuta
 - 15–30 minuta
 - 31–60 minuta
 - Mbi 1 orë
5. Sa e lehtë është për ju të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën kur keni nevojë për ndihmë?
 - Shumë e lehtë
 - E lehtë
 - E vështirë
 - Shumë e vështirë
6. Çfarë pengesash keni për të shkuar në qendrën shëndetësore / ambulancën? (mund të zgjidhni më shumë se një)



- Distanca e madhe
 - Nuk ka transport
 - Orari nuk është i përshtatshëm
 - Nuk kam para për shërbimin
 - Duhet të kujdesem për fëmijët
 - Frikë ose turp
 - Nuk kam pengesa
7. A ofron qendra shëndetësore / ambulanca shërbime për gratë ose vajzat që kanë përjetuar dhunë?
- Po
 - Jo
 - Nuk e di
8. Nëse do të përjetonit dhunë, sa e mundshme do të ishte që të kërkonit ndihmë në qendrën shëndetësore / ambulancën?
- Shumë e mundshme
 - E mundshme
 - Pak e mundshme
 - Aspak e mundshme
9. Sa e informuar ndiheni për shërbimet që qendra shëndetësore / ambulanca ofron për dhunën?
- Shumë e informuar
 - Pjesërisht e informuar
 - Aspak e informuar
10. A ndiheni e sigurt që të shkoni në qendrën shëndetësore / ambulancën pa pasur dikë nga familja me vete?
- Po
 - Jo
 - Ndonjëherë
11. A mendoni se stafi i qendrës shëndetësore / ambulancës respekton privatësinë e grave dhe vajzave që kërkojnë ndihmë?
- Po
 - Jo
 - Nuk e di
12. A ndiheni e dëgjuar dhe e trajtuar me respekt nga stafi i qendrës shëndetësore / ambulancës?



- Gjithmonë
 - Shpesh
 - Rrallë
 - Asnjëherë
13. A jep qendra shëndetësore / ambulanca informacion ose ju referon drejt shërbimeve të tjera (sociale, psikologjike, ligjore)?
- Po
 - Jo
 - Nuk e di
14. Sa e lehtë është që të referoheni nga qendra shëndetësore / ambulanca për të marrë shërbime të tjera?
- Shumë e lehtë
 - E lehtë
 - E vështirë
 - Shumë e vështirë
 - Nuk kam pasur përvojë
15. Si do ta vlerësonit marrjen e shërbimeve në qendrën shëndetësore / ambulancën për rastet e dhunës me bazë gjinore?
- Shumë e mirë
 - E mirë
 - Mesatare
 - E dobët
 - Shumë e dobët
16. Çfarë mendoni se do të përmirësonte më shumë aksesin në shërbime për gratë dhe vajzat në qendrën shëndetësore / ambulancën?
